



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 07/2009

Më 03. 03. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Sala Berisha – Shala dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Slobodan Petroviq, Múfera Şinik dhe Berim Ramosaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Izer Arifi dhe Remzije Hajdari - MTI, Petrit Hysa - OSBE, Ramadan Ilazi dhe Petrit Zogaj - Komisioni AD-HOC i shoqërisë civile kundër ngritjes së tarifave të energjisë elektrike, Blerina Uka – NDI dhe Ramadan Klisurica – KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23. 02. 2009;
3. Njoftim lidhur me propozimin për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike dhe shqyrtimi i Peticionit të Komisionit AD-HOC të shoqërisë civile, për çështjen e ngritjes së tarifave të energjisë elektrike;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave;
5. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

**Safete Hadergjonaj** – theksoj se shqyrtimi i peticionit të komisionit AD-HOC të shoqërisë civile ka qenë objekt shqyrtimi i komisionit për të drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, ku ky komision ka rekomanduar që peticioni të debatohet në Kuvend. Duke shtuar më tej se si komision funksional mund të flitët për propozimin për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike vetëm mbi bazen e fakteve, por sot nuk disponojmë me asnjë dokument që ka të bëjë me propozimin për ngritje të energjisë elektrike, tha znj.Hadergjonaj. Poashtu ajo tha se sot nuk janë prezent as përfaqësuesit e KEK-ut, KOSTT-it dhe ZRRE-së që kanë propozuar rritje, dhe është e pakuptueshme pse ata nuk janë prezent kur ne mbledhjen e fundit nga anëtarët e komisionit është kërkuar të ftohen. Z.Hadergjonaj pohoj se është mirë që sot nuk po debatohet pozite - opozite por të gjithë anëtarët e Komisionit janë kundër kësaj pike të rendit të ditës të papërgatitur nga ana e kryetarës së Komisionit. Në fund të diskutimit ajo ishte edhe kundër pikës së katërt të rendit të ditës pasi grupi punues ende nuk e ka përfunduar punën për amendamentimin e projektligjit për rezervat shtetërore dhe nuk ka paraqitur raportin si dhe kundër pikave të propozuara në të ndryshme nga kryetarja e Komisionit.

Për shkak të mospjesëmarrjes së përfaqësuesve të KEK-ut, ZRRE-së dhe KOSTT-it dhe për mungesën e materialit përkatës për çështjen e tarifave të energjisë elektrike, Komisioni e hoqi nga rendi i ditës pikën e tretë (3), për të debatuar në mbledhjen e radhës. Pika e katërt (4) e rendit të ditës hyri në vend të pikës së tretë (3).

## **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23. 02. 2009**

Procesverbali i mbledhjes së 23 shkurtit 2009, u miratua pa vërejtje.

## **III. Shqyrtimi i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave**

**Kryetarja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit, posaçërisht kryesuesen e Grupit të Punës znj. Hadergjonaj, se USAID-i e ka caktuar një ekspert për t'i ndihmuar Grupit të Punës që ta shqyrtojë Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave.

**Safete Hadergjonaj** – Theksoi se Grupi i Punës po e shqyrton Projektligjin. Njëherësh kërkoi që kur të caktohen ekspertë, paraprakisht të konsultohet Grupi i Punës, në mënyrë që fryma e bashkëpunimit ndërmjet ekspertëve dhe Grupit të Punës të jetë në nivel të duhur.

## **IV. Të ndryshme**

### **a) Çështje vijuese**

**Kryetarja** – E njoftoi Komisionin për vërejtjet që kanë ardhur nga USAID-i dhe për Projektligjin antidamping. Kërkoi nga Komisioni ta shqyrtojë në afat sa më të shkurtër Planin e veprimt, të miratuar në Kuvend.

Komisioni u pajtua që në mbledhjen e radhës pikë e rendit të ditës të jetë: çështja e tarifave të energjisë elektrike, të ftohen institucionet kompetente dhe të sillet material shtesë për këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 00.

Kryetare e Komisionit

---

Myzejene Selmani